



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e II-të të rregullt të punës për vitin 2019.

Seanca mbahet më 28.02.2019 (e enjte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.
Për këtë seancë propozohet ky

RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa,
5. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit, Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit dhe Prokurimit për vitin 2018 (ref. Drejtoria e FEZH),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2019, (ref. Kryesuesi i KKSBB),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2019 (ref. Zyrtari i Prokurimit),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Inicimit për ndërrimin e destinimit të objektit "Nojtra" nga objekti afarist në objekt banimi - pjesa e Komunës, (ref. Drejtoria e Urbanizmit dhe MM),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për ndërrim të destinimit të tretmanit të ndërtimit në parcelën 66-4 ZK Dresnik nga ai i banimit individual në afarizëm,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për formimin e Grupit Joformal të Grave Asamblastë me OJQ "Zana", (ref. Asamblastja, Blerta Gashi),
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit për ndarjen e Mirënjohjes "Frrok Gojani" me rastin e 7-Marsit- Ditës së Mësuesit (ref. Drejtoria e Arsimit)
12. Shqyrtimi:
 - I Rekomandimeve të MF dhe MMPH- lidhur me Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale /dhjetor 2018,
 - I Rekomandimeve të MPMS-lidhur me Statutin e QPS-Dhjetor/2018 - Klinë,
 - I Rekomandimeve të MSH-lidhur me Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale/dhjetor 2018,
13. Interpelanca e IPK-Gjokë Lleshaj me Drejtorin e Urbanizmit dhe MM.

01Nr. 06-722 2019
Klinë, më 20.02 2019

